

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kerkesa - Bojkoti/ Blushi kërkesë Kuvendit: Ndërhyni për zgjidhjen e konfliktit mes GJKKO e Dhomës së Avokatisë
ADRESA	https://www.syri.net/politike/918679/bojkoti-blushi-kerkese-kuvendit-nderhyni-per-zgjidhjen-e-konfliktit-mes-gjkkko-e-dhomes-se-avokatise/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:05:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 13:36:26 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	11f8ffa6f11b71d4c1f8feab886c6706d2598cd0c7aa1d75d992f3eba4cacee6
TEKSTI	d430d1ba6832674a9aebb20c397743630ee509b2ce8f10d2afd9cfa7ac99a2a5
PAMJA	b9d4e54a3147200b9473291d474c362331990fec33ef54c2917b61787895d38e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	16ab960537f059bb1c0e3e71be4e57ad032afb9edaab51abcd96dfa7fd4c4186
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/16ab960537f059bb1c0e3e71be4e57ad032afb9edaab51abcd96dfa7fd4c4186>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



ENVER BYTYÇI
Vendimi i Hagës dhe raporti
ynë me të vërtetën!



ENVER ROBELLI
Qëndrimi i Zagrebit dhe
heshija e Tiranës

LAJMI I FUNDIT

LIVE-Protesta e 116-të/ Shqiptarët në revoltë kundër qeverisë: Rama jep dorëheqjen



më të lexuarat

VIDEO-'Janë 3 orë përgjime'/ Ahmetaj:
Javën tjetër do publikojmë edhe dy
pasazhe të tjera. Monaco ...

Ura shembet 1 javë pas inaugurimit/
Vata: 40 mln lekë nga paratë e qytetarëve
të hedhura në lumë

Protesta e 53-të në Divjakë/ Banorët
vijnë qëndresën kundër propozimit të
PS për bashkimin me Lushnjën

Protesta e 114/ Mbyllen fjalimet para
Kryeministrit, qytetarët nisin
marshimin: Rama jepe dorëheqjen

'Rusia synon përçarjen'/ Burimi: Sulmet
hibride për të sjellë në pushtet forcat që
nuk ndihmojnë Ukrainën

VIDEO-'Hajde të tregoj unë ty'/
Përplasja me Ramën në avion, i ri: Më
humbi shpirtin dhe më shpirti...

Bojkoti/ Blushi kërkesë Kuvendit: Ndërhyni për zgjidhjen e konfliktit mes GJKKO e Dhomës së Avokatisë

15:36, 23/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë së Lirisë, Tedi Blushi shprehu shqetësimin serioz lidhur me përshkallëzimin e konfliktit institucional ndërmjet Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë, situatë e cila tashmë ka sjellë bojkotimin edhe të seancave për caktimin dhe shqyrtimin e masave të sigurimit.

Me kërkesë zyrtare drejtuar Kryetarit të Kuvendit, Niko Peleshi, Kryetarit të Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja dhe Kryetarit të Komisionit të Mbikqyrjes Institucionale, Fatmir Xhafaj i kërkon Kuvendit të ndërhyrjë menjëherë për zgjidhjen e konfliktit mes GJKKO Shkallë e Parë dhe Dhomës së Avokatisë.

Z. Kryetar i Kuvendit,

Në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, dëshiroj të shpreh shqetësimin tim serioz lidhur me përshkallëzimin e konfliktit institucional ndërmjet Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë, situatë e cila tashmë ka sjellë bojkotimin edhe të seancave për caktimin dhe shqyrtimin e masave të sigurimit.

Kjo situatë nuk mund të trajtohet më si një mosmarrëveshje e zakonshme ndër-institucionale apo si një çështje thjesht administrative. Përshkallëzimi i saj rrezikon të prodhojë pasoja të drejtpërdrejta mbi zhvillimin normal të proceseve penale, ushtrimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes, respektimin e afateve procedurale dhe, në mënyrë të veçantë, garantimin e procesit të rregullt ligjor.

Në këtë drejtim, është veçanërisht shqetësuese që avokatët ndodhen përballë një situatë ku, nga njëra anë, përballen me detyrimin për të respektuar vendimarrjen e organeve të tyre profesionale dhe, nga ana tjetër, me masa dhe pasoja procedurale të vendosura nga gjykata. Krijimi i një përplasjeje të tillë nuk i shërben as administrimit të drejtësisë, as funksionimit të organeve të drejtësisë dhe as...

as administrimit të drejtësisë, as funksionimit të pavarur të gjyqësorit dhe as ushtrimit të lirë dhe efektiv të profesionit të avokatit.

Rregullorja e Kuvendit, në nenin 18, përcakton se komisionet e përhershme, sipas fushave të përgjegjësisë, ndjekin zbatimin e ligjeve dhe kontrollojnë veprimtarinë e organeve përkatëse, duke propozuar marrjen e masave përkatëse. Ndërkohë, neni 102 u njeh komisioneve të përhershme të drejtën të kërkojnë shpjegime dhe informacion nga drejtuesit e institucioneve shtetërore, si dhe të kërkojnë dokumentacionin e nevojshëm dhe të zhvillojnë kontrole lidhur me çështje brenda fushës së tyre të përgjegjësisë.

Po kështu, kompetencat aktuale të Komisionit për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale përfshijnë shprehimisht koordinimin e dialogut dhe bashkëpunimit ndërinstitucional. Kjo e bën këtë komision një forum të përshtatshëm parlamentar për të ndihmuar në adresimin institucional të një ngërçi që po prodhon pasoja të rënda për funksionimin e drejtësisë.

Për sa më sipër, kërkoj nga Kryetari i Kuvendit që, në përputhje me kompetencat e Kuvendit dhe Rregulloren e tij, të mundësojë trajtimin me urgjencë të kësaj çështjeje në komisionet përgjegjëse dhe veçanërisht:

Thirrjen urgjente të një seance dëgjimore të Komisionit për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike dhe të Komisionit për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të GJKKO së Shkallës së Parë, Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe institucioneve të tjera që vlerësohen të nevojshme;

Kërkimin e informacionit dhe shpjegimeve të plota mbi shkaqet e krijimit të këtij ngërçi, efektet e tij konkrete mbi proceset gjyqësore dhe masat e marra nga secili prej institucioneve për parandalimin e pasojave mbi të drejtën e mbrojtjes dhe procesin e rregullt ligjor;

Nxitjen e një dialogu të drejtpërdrejtë institucional ndërmjet GJKKO-së dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë, me synim gjetjen e një zgjidhjeje të menjëhershme dhe të qëndrueshme, pa cenuar pavarësinë e gjyqësorit dhe kompetencat e organeve të avokatisë;

Vlerësimin e përputhshmërisë së kuadrit rregullator dhe praktikave të zbatuara me legjisllacionin në fuqi dhe standardet e procesit të rregullt ligjor, veçanërisht për sa i përket ushtrimit efektiv të funksionit të mbrojtjes;

Në përfundim të shqyrtimit, hartimin e një raporti dhe, nëse vlerësohet e nevojshme, propozimin e masave përkatëse institucionale ose legjislative, me qëllim parandalimin e përsëritjes së situatave të ngjashme.

Kuvendi nuk mund dhe nuk duhet të zëvendësojë gjykatat apo të ndërhyjë në vendimmarrjen gjyqësore. Por ai ka detyrimin kushtetues dhe parlamentar të ushtrojë kontrollin që i takon dhe të nxisë dialogun institucional kur një përplasje ndërmjet aktorëve të sistemit të drejtësisë rrezikon të cenojë funksionimin normal të tij dhe garantimin e të drejtave procedurale.

Në këto kushte, mbizotërimi i parimit të procesit të rregullt ligjor duhet të jetë kriteri udhëheqës për tejkalimin e këtij ngërçi. Çdo mosmarrëveshje institucionale duhet të zgjidhet përmes dialogut, proporcionalitetit dhe respektimit të kompetencave reciproke dhe nuk mund të lejohet të shndërrohet në një pengesë për funksionimin e drejtësisë penale.

Për këtë arsye, kërkoj që kjo çështje të trajtohet me urgjencë të veçantë parlamentare, përpara se pasojat e saj të bëhen edhe më të rënda dhe të prekin në mënyrë të pakthyeshme të drejtat e personave që janë aktualisht pjesë e proceseve penale.

Me respekt
Deputeti
TEDI BLUSHI

© SYRI.net

Lexo edhe:



'Ministri i krimit' / I riu: SPAK të mos e lejojë Edi Ramën të bëjë një drejtësi si pazar politik! Nesër te parlamenti




Qytetarët mbyllin fjalimet, nisin marshimin nëpër Tiranë: Rama, jepe dorëheqjen!



'Për 10 ditë Rama do ikë, fjalë burrash' / Thirrja e nënës për të rinjtë: Mos rrini në kafe, ejani këtu

kapi për qatë dhe me unë të zbulua



Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë



'S'ka normalitet për situatën ku ndodhemi', Këlliçi: Të gjithë e kanë pranuar skandalin e Roni Yeffet, Rama jo!



'Rama, një bandit që vjedh i pashqetësuar', Blushi: 'KAYO' e rivërtetoi se shteti është mafie sot!

TË NGJASHME



Vlora Hyseni e arrestuar/ Demiraj: Duhej mbledhur Këshilli i Sigurisë Kombëtare! Në SHBA janë të skandalizuar



VIDEO- 'Po kontrollohen faktet'/ Çela zbulon detaje nga dokumentari austriak për korrupsionin në Shqipëri



Berisha: Vetëm demokratët mund t'i japin goditjen përfundimtare këtij regjimi! Pa largimin e Ramës, Shqipëria vetëm do rrokulliset



'Rama jep dorëheqjen'! – Nis marshimi i qytetarëve nga sheshi 'Skënderbej' drejt Kryeministrisë



Berisha: Mbështetja e protestës qytetare, detyrë madhore e PD! Duhet të bëjmë çdo gjë për ripërtëritjen e partisë



VIDEO/ Berisha: Bojkoti do ishte avantazh për Ramën, ne do i japim atij përgjigjet më të forta në parlament



'Rama jep dorëheqjen'! - Shqiptarët në revoltë kundër qeverisë: Shteti ka rënë

LAJME POLITIKE KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.